



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština – Assembly**

---

**Legjislatura VI**

**Sesioni pranveror**

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike  
Mbledhja nr. 37  
Prishtinë, më 22 shkurt 2019, në orën 10:00  
Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-302

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Driton Selmanaj, Mërgim Lushtaku, Avdullah Hoti, Albert Kinolli, Emilija Rexhepi, Andin Hoti, Etem Arifi dhe Ali Lajçi.

**Munguan:** Valon Ramadani, Verica Ceraniç dhe Faton Topalli.

**Stafi mbështetës:** Antigona Ibraj, Mehmet Simnica dhe Ajet Avdullahu.

**I ftuar:** Kryeministri z. Ramush Haradinaj dhe sekretari Fitim Krasniqi nga ZKM-ja.

**Pjesëmarrësit tjerë:** Haki Shatri dhe Fitim Krasniqi nga ZKM-ja, Valdet Gjinovci nga AUV, Emine Fazliu, Samir Zymberi dhe Violeta Smajlaj nga ZKA-ja, Erdonit Retkoceri dhe Vatra Qehaja nga VV, Driton Qeriqi nga D4D, Fitore Ademi nga RTV21 dhe Drita Vitia nga Radio Kosova.

**Mbledhjen e kryesoi:** Driton Selmanaj, kryetar i komisionit.

**Rendi i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 15.02.2019;**
- 3. Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat vjetore financiare të ZKM-së për vitin 2017;**
- 4. Diskutimi lidhur me ndarjen e mjeteve financiare nga programi (232) shpenzimet e paparashikuara;**
- 5. Tërheqja e shortit për auditimin e raporteve financiare dhe atyre të deklarimit financiar të Subjekteve Politike për vitin 2017;**
- 6. Të ndryshme.**

*Kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.*

### **1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

### **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 15.02.2019**

*Procesverbali i mbledhjes, të mbajtur më 15.02.2019, u miratua me vërejtje nga anëtari i Komisionit, z. Avdullah Hoti.*

### **3. Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat vjetore financiare të ZKM-së për vitin 2017**

**Kryetari** njoftoi deputetët se bazuar në planin e punës së komisionit për vitin 2019, ne kemi bërë ndarjen e raporteve të auditimit për raportuesit sipas planit të punës së komisionit për vitin 2019. Raportues për Shqyrtimin e raportit të auditimit për pasqyrat vjetore financiare të ZKM-së për vitin 2017; jam unë. Theksoj se janë evidentuar një sërë shkeljesh në raportin vjetor të Auditorit. Në këtë raport ne kemi pa keqpërdorime në kategori të ndryshme. Ka punësime në Agjencinë e Veterinës pa respektuar rregullat e rekrutimit; raportim i dobët për subvencione, mosrespektimi i marrëveshjes me komuna të ndryshme. Çështje tjetër janë pagesat e dyfishta për fermerët në rastet e sëmundjes gungore të kafshëve. Ka mangësi në dhënien e llogarisë për subvencione. Këto janë disa të gjetura nga raportimi i Auditimit të ZKA-së për PVF të ZKM-së.

**Fitim Krasniqi** tha se e kanë parë raportin dhe se i kemi marrë të gjitha masat pas raportimit. Zyra e Kryeministrit ka shumë agjenci brenda saj dhe ato kanë pavarësi të financave. Pas miratimit të planit të veprimit ne e kemi adresuar këtë plan të ZKA-ja dhe të komisioni i juaj. Lidhur me raportin çka ka të bëjë direkt më Zyrën e Kryeministrit, ne kemi dy rekomandime dhe ka qenë një gabim teknik, por në planin e veprimit për adresim të rekomandimeve ne kemi përfshirë edhe masat tona që do të ndërmarrim si ZKM.

**Valdet Gjinovci**, drejtori i AUV-ut, tha se i kanë ndërmarrë të gjitha masat pas raportit të Auditimit për shpenzime. Lidhur me klasifikimin e mjeteve është proces që na ka përcjellë që nga viti 2007, por tash kjo është zgjidhur dhe të gjitha mjetet janë orientuar në sektorët përkatëse. Prej këtij viti nuk do të realizohen pagesat të fermerët ashtu qysh janë bërë deri tash. Lidhur me kontratat me shërbime të veçanta tashmë kemi ndërprerë dhe nuk ekziston asnjë kontratë e tillë. Agjencia e Ushqimit ka marrë veprime dhe kanë realizuar kthimin e mjeteve të fermerët.

**Avdullah Hoti**, pyeti se pse gjatë vitit 2017 kemi rritje të obligimeve të papaguara në krahasim me vitin paraprak, nga 23 mijë euro në 632 mijë euro, pse është kjo rritje? Po ashtu në pozicionin e detyrimeve kontigjente kemi rritje nga 77 mijë në 853 mijë? Po ashtu pyeti përfaqësuesin e AVUK lidhur me pagesat e dyfishta të bëra dhe anulimi i tyre, po ashtu pyeti se pse është lejuar që zyrtari i prokurimit nuk e ka nënshkruar dosjen e tenderit. Në disa raste është pranuar fatura më pastaj është plotësuar urdhër blerja. Pse është lejuar një gjë e tillë, cilat masa janë ndërmarrë ndaj personave përgjegjës?

**Fitim Krasniqi** theksoi se sa herë kemi ndryshim të kabinetit Qeveritar kemi rritje edhe të shpenzimeve, detalet për këtë nuk i kam këtu, po nëse kërkohet mund t'ua sigurojmë.

**Valdet Gjinovci** foli për detyrimet kontingjente, dhe tha se kjo shumë në vitin 2018 është ulur, pra nga 853 mijë sa ishte në vitin 2017 është ulur në 425 mijë, kjo ka ndodhur në rastin kur kemi konfiskim të kafshëve, pra deri sa janë kryer procedurat gjyqësore. Sa i përket urdhër blerjeve të AVUK është pak sa telashe, mirëpo edhe në këtë fushë kemi bërë progres.

**Emilija Rexhepi** theksoi se brenda Zyrës së Kryeministrit kemi dy Agjenci të Pavarura, dhe gjatë mandatit të kaluar unë kam qenë anëtare e Komisionit Funkcional për Bujqësi dhe jam e familjarizuar me punën e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës. Në raportin e Auditimit kemi disa të gjetura të cilat ishin edhe afera të ndryshme si p.sh. sa i përket vaksinimit. Po ashtu sa i përket zyrës për komunitete për herë të parë këtu kemi mundësi të kemi qasje si të ishte e jona, pra e të gjitha komuniteteve. Jo vetëm e komunitetit serb apo të një grupi brenda këtij komuniteti. Pra, nga ky vit ne kemi ndihmesë nga Zyra për Komunitete brenda Zyrës së Kryeministrit.

**Haki Shatri**: Në të kaluarën ka pasur njëanshmëri për komunitetin serb, mirëpo ZKM ka nxjerrë një rregullore për mënyrën e shpërndarjes së buxhetit në nivel të drejt për të gjitha komunitetet.

**Avdullah Hoti** theksoi se për shpërndarjen e buxhetit në nivel të Zyrës së Kryeministrit programi për komunitetet në MKK, si dhe në ministritë e tjera të cilat ndajnë buxhet për komunitetet në Qeverisë e kaluar është vendosur që t'ju mundësohet të gjitha komuniteteve të konkurrojnë me projektet e tyre dhe idetë e tyre për të marrë fonde nga institucionet e cekura më lart. Mirëpo në këtë Qeveri është devaluuar kjo praktikë e mirë e cila ishte instaluar.

**Haki Shatri** theksoi se në vitin 2017, kur qeveria e re ka filluar punën ne kemi gjetur një shumë të mjeteve të pashpenzuara, e që sipas sqarimeve që kemi marrë nga administrata na është thënë se kjo shumë e mjeteve është buxhetuar në bazë të kërkesave të komunitetit serb.

**Etem Arifi** theksoi se kishte me qenë mirë që auditori i jashtëm të bënë një auditim të mënyrës së buxhetimit dhe shpenzimit të shumës së mjeteve të ndarë dhe shpenzuar në kuadër të programit për komunitete dhe kthim në kuadër të ZKM-së. Ekziston vetëm një vendim për sa i përket ndarjes së mjeteve për komunitete për festat zyrtare, ndërsa ndarje të mjeteve për nevoja të tjera për komunitetin që unë përfaqësoj nuk ka pasur.

**Albert Kinolli** tha se për vitin 2018, situata është përmirësuar dukshëm. Një pjesë e kërkesave të komunitetit që unë përfaqësoj janë përkrahur veçanërisht në ndërtimin e shtëpive.

### *Përfundim*

*KMFP vendosi që raporti i auditimit për PVF- të e ZKM-së për vitin 2017, të mos adresohet për në Seancë Plenare.*

#### **4. Diskutimi lidhur me ndarjen e mjeteve financiare nga programi (232) shpenzimet e paparashikuara**

**Kryetari** tha se ne për këtë pikë kemi ftuar Kryeministrin e Kosovës z. Ramush Hardainaj, por ai nuk i është përgjigjur ftesës tonë, sepse në këtë pikë kemi dashur t'i diskutojmë kërkesat dhe vendimet për ndarjen e mjeteve financiare nga programi shpenzimet e paparashikuara (232) kategoria e rezervave nga Qeveria e Republikës së Kosovës për vitin 2019, e në veçanti ndarja e shumës së mjeteve prej 500,000 euro për festimin e 11 vjetorit të pavarësisë. Po ashtu njoftoi se administrata ka siguruar edhe vendimet e Qeverisë edhe kërkesat lidhur me këto vendime. Mendoi se shuma e ndarë për këtë vit është shumë e lartë dhe pa u respektuar procedurat e konkurueshmërisë. Vitin e kaluar ishte ndarë shumë me pak buxhet se këtë vit, mirëpo ka fundi i vitit me rishikim të buxhetit është ndarë buxhet për të mbuluar obligimet të cilat ishin krijuar me rastin e festimit të 10 vjetorit të pavarësisë. Po ashtu tha se ky buxhet është dashtë të planifikohet në fillim viti me buxhet të rregullt. Vitin e kaluar Qeveria ka ndarë 8.3 milionë euro nga programi shpenzimet e paparashikuara.

**Mërgim Lushtaku** tha se Qeveria e Kosovës më mirë kishte me qenë me marrë vendime për ndarjen e mjeteve për mirëqenie sociale të qytetarëve se sa të ndahet një shumë prej 500,000 euro për festimin e 11 vjetorit të pavarësisë.

**Avdullah Hoti** theksoi se në bazë të materialeve që kemi nga administrata e komisionit shihet se buxheti në shumën prej 500,000 eurove është ndarë në bazë të një kërkesë të një kompanie private „Dizarjium”. Me ofertë një burimore. Kjo në fakt le të kupton seriozitetin e Qeverisë, duke marrë parasysh edhe lartësinë e shumës së ndarë për këtë aktivitet. Prandaj unë propozoj që ne, si komision, ta kërkojmë një raport të detajuar lidhur me këto vendime të Qeverisë dhe në një takim të radhës ta ftojme përsëri Kryeministrin për t'i diskutuar këto çështje.

**Kryetari** tha se meqenëse nuk është Kryeministri prezent apo njëri nga zëvendëskryeministrat, ne nuk kemi as si ta shtjellojmë më tutje këtë pikë, prandaj do ta vlerësojmë si komision se si do të veprojmë më tutje për këtë çështje.

#### **5. Tërheqja e shortit për auditimin e raporteve financiare dhe atyre të deklarimit financiar të Subjekteve Politike për vitin 2017**

**Kryetari** tha se në këtë pikë ne e kemi një obligim ligjor, pra, ta bëjmë tërheqjen e shortit për auditimin e raporteve financiare dhe atyre të deklarimit financiar të subjekteve politike për vitin 2017. Në këtë dosje të tenderit do të auditohen 19 subjekte politike dhe për këtë me short do të zgjedhën 10 auditorë të cilët janë përfshirë në dosje të tenderit. Me këtë e fillojmë tërheqjen e shortit.

Pas tërheqjes së shortit renditja duket kështu.

**Grupi 1**

Ymer Shatri	PDAK	3	2017
	KDTP	7	2017

**Grupi 2**

Emri Osmani-Shatri	Serbe Lista	10	2017
	AAK	9	2017

**Grupi 3**

Njazi Jakupi	JGP	17	2017
	PLE	1	2017

**Grupi 4**

Haxhi Nimanaj	PDK	13	2017
	SLS	19	2017

**Grupi 5**

Besa Berisha	GISL	16	2017
	VV	8	2017

**Grupi 6**

Muhamet Feka	LDK	12	2017
	KNRP	14	2017

**Grupi 7**

Fatmir Mehmeti	PDS	4	2017

**Grupi 8**

Fadil Hyseni	NDS	2	2017
	NISMA	5	2017

**Grupi 9**

Agron Mustafa	VAKAT	6	2017
	PAI	15	2017

**Grupi 10**

Sebahate Hasani	KZA	11	2017
	PREBK	18	2017

*Përfundim*

*KMFP ka kryer procesin e shortit për auditorët që do të bëjnë Auditimit e raporteve financiare dhe atyre të deklarimit financiar të fushatës së subjekteve politike për vitin 2017, sipas tabelës së bashkangjitur këtij procesverbali.*

**6. Të ndryshme.**

Pasi nuk pati diskutim për pikën 6, mbledhja u shpall e mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30.

**E përgatiti:**

**Stafi mbështetës i komisionit**

**Kryetari i komisionit,**

**Driton Selmanaj**